

VENDIM
Nr. 57, datë 31.1.2018

PËR MONITORIMIN SHKENCOR PASVAKSINAL TË KAFSHËVE TË VAKSINUARA NË KUADËR TË PROJEKTIT “PAZA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 61/2016, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e gjuetisë së dhelprës së kuqe, për arsye të monitorimit shkencor pasvaksinal, që realizohet në kuadër të projektit “Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit ndaj sëmundjeve zoonotike” (“PAZA”).
 2. Gjuetia e dhelprës së kuqe të kryhet nëpërmjet marrjes së kampionëve të dhelprës së kuqe në të gjithë territorin e vendit, me përjashtim të territorit të zonave të mbrojtura, gjatë një periudhe njëmuajore në ditët e enjte, e premte dhe e shtunë, duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
 3. Për marrjen e kampionëve të dhelprave të kuqe, nëpërmjet gjuajtjes së tyre, të angazhohen në të gjithë vendin 39 punonjës të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të pajisur me shenjë dalluese për këtë proces, që do të sigurojnë në total 324 kampionë të dhelprave të kuqe. Punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, që do të realizojnë marrjen e kampionëve në çdo qark, si dhe numri i individëve/kampionëve të dhelprave që do të sigurohen për secilin qark, jepen në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, pajis punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në çdo qark me autorizimin përkatës për marrjen e kampionëve të dhelprës së kuqe.
 5. Gjatë të gjithë kohës së kryerjes së kësaj veprimtarie në zonat ku do të kryhet marrja e kampionëve të dhelprave, procesi do të kontrollohet nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.
 6. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të bashkërendojë punën për marrjen e kampionëve të dhelprave të kuqe, dërgimin e tyre në laboratorët përkatës, analizimin dhe nxjerrjen e rezultateve, si dhe raportimin për përfundimin e fazës së tetë të procesit të monitorimit pasvaksinal kundër sëmundjes së tërbimit të dhelprës së kuqe në Shqipëri.
 7. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**“PËR MONITORIMIN SHKENCOR PASVAKSINAL TË KAFSHËVE TË VAKSINUARA
NË KUADËR TË PROJEKTTIT PAZA” (FAZA 8)**

**LISTA E GJUESTARËVE PËR SIGURIMIN E KAMPIONËVE LABORATORIKË,
NUMRI I KAMPIONËVE TË DHELPRAVE TË KUQE QË DUHEN SIGURUAR**

Nr.	Emër Mbiemër	Vendndodhja	Qarku	Nr. i armës	Nr. i dhelprave për çdo qark
1	Ervin Jaupaj	Tiranë	Tiranë	186504	
2	Nazmi Kamberi	Tiranë	Tiranë	58386	
3	Skender Cani	Tiranë	Tiranë	24484	
4	Ervin Kullaku	Tiranë	Tiranë	T230481R	
5	Shefqet Dajti	Tiranë	Tiranë	31168	
			Tiranë		13
6	Jani Ranxha	Elbasan	Elbasan	84866	
7	Bashkim Koçi	Librazhd	Elbasan	92029303	
8	Ardi Bodurri	Elbasan	Elbasan	137166	
			Elbasan		37
9	Ramiz Koxha	Burrel	Dibër	F 078244	
10	Maringlen Lena	Burrel	Dibër	n/a	
11	Preng Gjonaj	Urake	Dibër	92116907	
			Dibër		24
12	Kreshnik Toni	Vain	Lezhë	121243	
13	Geg Paloka	Fushëkuqe	Lezhë	9219668	
14	Pashk Noka	Vain	Lezhë	347441	
15	Rozar Ujka	Kune	Lezhë	F020104	
16	Gjergje Dedaj	Mirditë	Mirditë	105176	
			Lezhë		12
17	Halim Çelmamaj	Krujë	Durrës	H68000F	
18	Asllan Xhakaj	Krujë	Durrës	9544496	
19	Shefqet Paja	Krujë	Durrës	119580	
			Durrës		10
20	Shaqir Hysenbelliu	Skrapar	Berat	1218234	
21	Beqir Sheti	Berat	Berat	122952	
22	Dine Kanani	Berat	Berat	9107160	
23	Skender Selenica	Berat	Berat	774	
24	Bedri Ormenaj	Berat	Berat	99706449	
			Berat		21
25	Nazir Markgjekaj	Tropojë	Kukës	47871	
			Kukës		20
26	Edvin Tuci	Përmet	Gjirokastër	T-230431-R	
27	Vasil Vlashi	Gjirokastër	Gjirokastër	9001835	

			Gjirokastrë		38
28	Llazar Xamo	Novoselë	Vlorë	10482	
29	Nikolla Niko	Sarandë	Vlorë	9110442	
			Vlorë		36
30	Erind Mine	Fier	Fier	9447810	
31	Adriatik Kaja	Lushnjë	Fier	AH 33627	
32	Gramoz Murrizi	Lushnjë	Lushnjë	138-22	
33	Fatos Jolla	Lushnjë	Fier	AH11659	
			Fier		24
34	Agim Dardha	Shkodër	Shkodër	D-39036	
35	Pellumb Guri	Shkodër	Shkodër	P-87145-E	
			Shkodër		36
36	Vasil Male	Prespë	Korçë	92027524	
37	Julian Kodra	Korçë	Korçë	6030648	
38	Ymer Mecollari	Korçë	Korçë	9553242	
39	File Qyrani	Korçë	Korçë	684	
			Korçë		53